

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“GENOTECH TRADING” SH.P.K**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“GENOTECH TRADING” Sh.p.k.**

1- HASSAN MOSAAD HASSAN MOSAAD GOMAA, atesia **MOSAAD**, shtetas Egjptian , lindur me 23/04/1970 **DAKAHLIYA** , identifikohet nepermjet pasaportes A11447593.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **“GENOTECH TRADING” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte **“GENOTECH TRADING” Sh.p.k.**,

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga **“GLAUKIA”** Lagja 17, Brenda Ambienteve te Tregut Industrial, Durrës, Shqiperi. Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.



NENI 4
KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**GENOTECH TRADING**” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të :

5.1 Import-eksport, prodhim e tregtim, me shumice e pakice te artikujve industrial si naftë, benzinë,gaz, vaj për makina; artikujve te ndryshem ushqimor;mineraleve te te gjitha llojeve; materialeve te ndertimit; te paisjeve elektrike dhe elektronike; te mjeterve te ndryshme te transportit tokesor, uJOR dhe ajror si dhe pjeseve te tyre; te makinerive per prodhim ,amballazhim te te gjitha llojeve ; te paisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit publik, industrial, bujqesor, tregtar, ushqimor, mjeksor, farmaceutik, sportiv, kulturor etj.Import-eksport, prodhim e tregtim, me shumice e pakice te artikujve industrial si naftë, bezninë,gaz, vaj për makina; artikujve te ndryshem ushqimor;mineraleve te te gjitha llojeve; materialeve te ndertimit; te paisjeve elektrike dhe elektronike; te mjeterve te ndryshme te transportit tokesor, uJOR dhe ajror si dhe pjeseve te tyre; te makinerive per prodhim ,amballazhim te te gjitha llojeve ; te paisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit publik, industrial, bujqesor, tregtar, ushqimor, mjeksor, farmaceutik, sportiv, kulturor etj.


Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind Mije Leke), i ndare në 1 pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1- HASSAN MOSAAD HASSAN MOSAAD GOMAA	100,00 %
--------------------------------------	-----------------

AKT THEMELIMI “GENOTECH TRADING” Sh.p.k



Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqëria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “**GENOTECH TRADING**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator të shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emeruar Eduart Memia.

NENI 9

DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje apo konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 16.10.2018

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE “GENOTECH TRADING” SH.P.K.

HASSAN MOSAAD HASSAN MOSAAD GOMAA

